



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:268225

Datë: 08.01.2020

Numri i dokumentit: 00750745

Pnr. 1007/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA VUSHTRRI, Gjyqtari Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike - praktikantës Doruntina Maloku , duke vendosur në lëndën penale ndaj të akuzuarit Q. B. nga fshati S. komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Vjedhje e Pyllit nga neni 358 par par.1 te KPRK- se, duke vendosur sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II-nr.3280/19 dt.15.11.2019, dhe kërkesës për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor të paraqitur në të njëjtën aktakuzë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, në mbështetje të nenit 385 të KPRK-së, me datë 17.12.2019, nxjerre këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dhe ipet:

URDHËRI NDESHKIMOR

Kundër të akuzuarit:

Q. B. nga i ati Q. i lindur me ... nga fshati S. komuna e Vushtrrisë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën datën 12.04.2018 rreth orës 14:4 ,ne pyllin shoqëror që menaxhohet nga Drejtoria për ekonomi, bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural në pronësi komunale e fsh. S. – Vushtrri, në vendin e quajatur “S.” pa leje me qëllim vjedhje ka prerë dhe marrë 66 trungje dru të llojit “Shkozë”, me diametër 12-14 cm, me gjatësi 9 metra me vëllim prej 3.30 m3, në vlerë të dëmit prej 504.90 euro,

Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 par .1 të KPRK- së.

Andaj gjykata komformë dispozitave të neneve 17, 41, 46, 73 e 358 te KPRK-së dhe nenit 365 e 495 të KPPK-ës,

G J Y K O N

DENIM MË GJOBË në shumë prej 400 € (katërqind euro), të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të zëvendësoi dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur 20€, për një ditë të kaluar me burg.

I akuzuari obligohet që në emër të kompensimit të dëmit, të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim – Pylltaria, zyra në Vushtrri, t’ia paguaj shumën prej 504,90 €,

Ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë te paguaj shumën prej 25€,(njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën nr. PP.II-nr. 3280/19 dt.15.11.2019, po ashtu është parashtruar edhe kërkesa për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor, kundër te pandehurit Q. B. për shkak të veprës penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 par .1 të KPRK- së.

Gjykata shqyrtoj Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa janë të bazuar ne baze te nenit 495 te KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-ës, që pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor të merr vendim për urdhër ndëshkimorë si në dispozitiv, pasi qe nga shkresat e lëndës vërtetohet se ka prova të mjaftueshme, të cilat vërtetojnë fajësinë e te akuzuarit se ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë sipas Aktakuzës se Prokurorit te Shtetit.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat te cilat janë të mjaftueshme e për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit, se ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës se prokurorisë, kjo vërtetohet nga provat si vijojnë dhe atë: Fletëparaqitje për dëmtimin e pyllit i datës 12.04.2018 si dhe Vlerësimi dhe llogaritja e dëmit në pyll i datës 18.04.2018.

Sipas KPRK-se, për vepra penale – Vjedhje e pyllit nga neni 358 par 1 të KPRK-ës, dënimi për këtë veprë penale është dënim me gjobë ose burgim deri në një (1) vit.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata mori parasyshë rrethanat: si shkallën e përgjegjësisë penale, dhe faktin se i akuzuari është i njohur per vepra penale te kësaj natyre.

Gjykata në përputhje me nenin 73 të KPRK-se, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, vlerësoj rrethanat ne matjen e dënimit, duke vlerësuar se një dënim i tille është adekuat dhe është i përballueshëm për të akuzuarin në raport me gjendjen e tij ekonomike dhe me këtë dënim do te arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 41 te KPRK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori komform nenit 450 të KPP-ës.

Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE DEGA VUSHTRRI

**Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal
P.nr.1007/19 dt.17.12.2019.**

**Sekretarja juridike- Praktikantja
Doruntina Maloku**

**GJYQTARI
Ferki Xhaferi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afate prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me goje në procesverbal të gjykatës.